



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:167303
Datë: 15.12.2021
Numri i dokumentit: 02511509

PA1.nr.998/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. G., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 315 par. 1 lidhur me nenin 28, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për të vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.916/20, datë 07.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës , me datë 28.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.916/20, datë 07.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.916/20, datë 07.06.2021, të akuzuarin B. G. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 315 par. 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe të njëjtin për shkak të kësaj vepre penale e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me dënim me gjobë në shumë

prej 500,00€ e të cilin dënim do ta paguajë brenda 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënim me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro. I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari është obligua që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E dëmtuara, për realizimin e kërkesës juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, nga neni 387 të KPP-së, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin ankimor ta ndryshojë, ashtu që të akuzuarit ti shqiptojë dënim më të ashpër se sa dënimi i shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.1014/2021, datë 03.08.2021, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 916/2020 të datës 07.06.2021, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës në të cilën i ftoi palët, Prokurorin e Apelit, të akuzuarin B. G., të dëmtuarën M. M. Në seancë nuk prezantoi dhe nuk mori pjesë asnjë nga palët. Gjyqtari referues në prezencë të kolegjit e referoi lëndën në fjalë.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, e edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve. Për këtë arsye,

aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënimin.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionet penale, nga neni 387 të KPP-së. Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato as sesi në rastin konkret nuk do të duhej të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikojnë që dënimin e paraparë ligjor për këtë veprë penale të zbutet deri në këtë masë ku të akuzuarit ti shqiptohet dënim kaq i butë. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit ka bërë tejkalim të kompetencave ligjore, gjykata i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese si dhe ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit, për këtë arsye prokurori me qëllim të luftimit të këtij lloji të kriminalitetit propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara, përgjegjshmërinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit, që të akuzuarit të i shqiptohet dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit më të ashpër, ndaj të akuzuarit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese. Kështu gjykata si duke u mbështetur në nenin 70 par. 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, për të akuzuarin mori parasysh rrethanat lehtësuese mori se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, keqardhjen e shfaqur në shqyrtimin fillestar dhe bashkëpunimin e të pandehurit me organet e ndjekjes qysh në fazën e hershme të procedurës penale, ndërsa rrethana rënduese mori shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit, dënimet penale të mëparshme të të akuzuarit dhe atë me aktgjykimet e formës së prerë të kësaj gjykate. Një vlerësim të këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të prokurorit nuk kanë ndikim që të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i ashpër. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.998/21, më datë 28.10.2021

Zyrtarja ligjore,
Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Kryetar i kolegjit,
Hashim Çollaku

Zyhdi Haziri